
INTERVISTË ME AMBASADOREN E TURQISË NË KOSOVË, SONGUL OZAN

Marrëdhënie vëllazërore Turqi - Kosovë

"Turqia është ndër vendet e para që e njohu Kosovën. Sikur para pavarësisë, edhe pas shpalljes së saj, marrëdhëniet ndërmjet Turqisë dhe Kosovës janë duke u avancuar në vazhdimësi, në çdo fushë. Vizitat reciproke të niveleve të larta, marrëdhëniet tona tejet të zhvilluara ekonomike, tregtare, arsimore, kulturore, në çështjet e sigurisë e shëndetësisë, kontaktet e dendura ndërmjet politikanëve tanë, si dhe bashkëpunimet ndërmjet organizatave joqeveritare



të rëndësishëm në çdo fushë dhe ky fakt na bënë tejet të kënaqur. Një fjalë e urtë thotë: Çdo fillim është i vështirë. Është normale, ky vend i cili është në fillim të rrugës ka probleme të rëndësishme, të cilat duhet t'i tejkalojë. Unë besoj nga zemra se kjo do të arrihet falë vullnetit, vendbashku me vëllezërit dhe miqtë tanë kosovarë, po angazhohemi që ky vend i bukur dhe marrëdhëniet Turqi-Kosovë të avancohen. Ne na nxit edhe më tej qëndrimi konstruktiv dhe mbështetës që e hasim në të gjitha institucionet dhe te i gjithë populli i Kosovës. Ne jemi të kënaqur

politikës sonë për Ballkanin. Në këtë aspekt, Turqia kontribuon në zgjedhjen e problemeve duke mbajtur dialogë të niveleve të larta me vendet e rajonit. Ne këtë rajon e shohim si qendër të Ballkanit, si dhe dëshirojmë që duke u bazuar në kufijtë ekzistues të integrohet sa më shpejt në qarqet euro-atlantike dhe besojmë se e ardhmja e vendeve të Ballkanit duhet të jetë nën ombrellën e qarqeve euro-atlantike.

"Kosova Sot": Turqia ka ndërmarrë disa misione ndërmjetësimi në vendet e rajonit. Ajo e ka një komunikim të mirë edhe me Beogradin. Siç dihet, Beogradi vazhdon t'i mbështesë strukturat ilegale në veri, të cilat kërcënojnë për një referendum për ndarje. A mund ta thoni opinionin tuaj lidhur me këtë çështje?

Ambasadorja Ozan: I gjithë angazhimi i Turqisë fokusohet në një qëllim; në arritjen e paqes dhe të stabilitetit të qëndrueshëm në të gjitha vendet e Ballkanit, të cilat veç kanë vuajtur shumë nga luftërat, përleshjet, presionet dhe mundimet tjera. Turqia ka marrëdhënie në fusha të

Sipas jush, kur mund të konkretizohet ky bashkëpunim?

Ambasadorja Ozan: Më 15 shkurt të vitit 2005, ndërmjet institucioneve të arkivave të dy vendeve veç është nënshkruar një marrëveshje protokollare e bashkëpunimit. Marrëdhëniet ndërmjet arkivave tanë janë ende shumë të afërta.

31 marrëveshje bashkëpunimi

"Kosova Sot": Turqia ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në fusha të ndryshme. Në cilat fusha janë të interesuar të investojnë investitorët turq në Kosovë?

Ambasadorja Ozan: Para dhe pas pavarësisë, ndërmjet Kosovës dhe Turqisë janë nënshkruar gjithsej 31 marrëveshje bashkëpunimi. Shumica prej tyre janë marrëveshje të fushës ekonomike. Gjithsesi, kemi edhe marrëveshje bashkëpunimi në fusha të tjera, si në kulturë, shëndetësi, arsim e shkencë. Jemi në përgatitje e sipër për marrëveshje të reja. Kuptohet, avancimi i marrëdhënieve ekonomike mbetet me prioritet për

duke u zgjeruar dhe thelluar pandërprerë", thotë Songul Ozan, ambasadore e Turqisë në Kosovë, në intervistën për "Kosova Sot"

Ambasadorja e Turqisë në Kosovë, znj. Songul Ozan, në një intervistë për gazetën numër 1 "Kosova Sot", ka folur rreth marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, të cilat janë duke u intensifikuar në rrafshin diplomatik dhe ekonomik, ndërkohë që për herë të parë është deklaruar lidhur me spekulimet e zëvendësimit të trupave amerikanë në kampin amerikan Bondstil me trupat turke.

"Kosova Sot": E nderuara ambasadore, tash një vit jeni në detyrë në Kosovë. A mund të nxirrni një konkluzion për zhvillimet në Kosovë?

Ambasadorja Ozan: Ka afro 25 vjet që jam në detyrë si diplomate. Që nga fillimi i karrierës sime kam pasur interesim të veçantë për Ballkanin. Derisa isha një diplomate e re, 16 vjet më parë, kam shërbyer dy vjet me kënaqësi në Tiranë. Ndërkaq tani, të qenit në detyrë në shtetin më të ri të Ballkanit dhe Evropës në Kosovë, të qenit dëshmitare në përparimet e të gjitha fushave të këtij vendi, vëzhgimi i angazhimeve dhe vullnetit që ky vend posedon për integrim në institucionet euroatlantike, më jep kënaqësi dhe emocion. Me të vërtetë, ne e shohim se Kosova po bën hapa

"Kosova Sot": Në ç'drejtim po zhvillohen marrëdhëniet Kosovë-Turqi?

Ambasadorja Ozan: Siç e dini, Turqia është ndër vendet e para që e njohu Kosovën. Sikur para pavarësisë, edhe pas shpalljes së saj, marrëdhëniet ndërmjet Turqisë dhe Kosovës janë duke u avancuar në vazhdimësi, në çdo fushë. Vizitat reciproke të niveleve të larta, marrëdhëniet tona tejet të zhvilluara ekonomike, tregtare, arsimore, kulturore, në çështjet e sigurisë e shëndetësisë, kontaktet e dendura ndërmjet politikanëve tanë, si dhe bashkëpunimet ndërmjet organizatave joqeveritare dhe universiteteve tona janë duke u zgjeruar dhe thelluar pandërprerë. Thuaja të gjitha institucionet dhe organizatat në Kosovë kanë projekte të përbashkëta me homologët e tyre në Turqi. Gjithashtu, ekzistimi i shumë vëllezërve tanë shqiptarë, boshnjakë, turq e goranë këtu dhe në Turqi, lidhjet e tyre farefisnore, ua shtojnë një pasuri të veçantë marrëdhënieve tona njerëzore dhe i forcojnë ato. Ne na bën krenarë fakti se turqit këtu, si qytetarë të Kosovës, shërbejnë në shumë fusha si politike, administratë lokale, drejtësi, kulturë e shtyp. Qytetarët dhe të afërmit tanë këtu janë lidhja më e vlefshme në marrëdhëniet tona. Ne si Republikë e Turqisë, me ambasadën, me ushtarët tanë në KFOR, me policët tanë në EULEX, me TIKA-n, me qendrat kulturore të "Yunus Emre", me nëpunësit tanë në institucionet e ndryshme ndërkombëtare, me sektorin tonë privat, shkollat, institucionet arsimore e spitalet tona, së

torike dhe gjithashtu na gëzon fakti se i njëjti qëndrim paraqitet edhe nga Kosova, motër e mike.

Dialogu të përfundojë me sukses

"Kosova Sot": Ndër prioritetet e diplomacisë turke gjendet edhe Ballkani. A mund të na komentoni dimensionet e marrëdhënieve Turqi-Ballkan?

Ambasadorja Ozan: Turqia me historinë, kulturën dhe gjeografinë e saj është një vend i Ballkanit dhe ka lidhje të thella historike, sociale, kulturore dhe njerëzore me të gjitha vendet e rajonit. Në vendin tonë jetojnë milionë qytetarë turq me origjinë ballkanase. Njëherësh, në të gjitha vendet e Ballkanit jetojnë miliona qytetarë dhe të afërm tanë. Në politikën tonë për rajonin, faktori njeri është në qendër të vëmendjes. Pra, esenciale janë dimensionet njerëzore. Me këtë qëllim, sigurimi i paqes dhe stabilitetit në rajon, krijimi i një rajoni të stabilitetit me arritjen e rimëkëmbjes ekonomike janë prioritetet e

e Ballkanit. Në këtë kuptim, ne besojmë që marrëdhëniet tona me Serbinë kontribuojnë në stabilitetin dhe paqen në rajon. Turqia është ndër vendet e para që e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Ne me çdo rast, në çfarëdo platformë, i shprehim hapur qëndrimet tona lidhur me pavarësinë e Kosovës, ruajtjen e tërësisë territoriale dhe sovranitetit të saj. Qëndrimi ynë u ritheksua personalisht edhe nga ministri ynë i Jashtëm në muajin gusht, i cili e vizitoi Kosovën si i ftuari i ministrit të nderuar Hoxhaj. Rrjedhimisht, bashkëpunimi dhe marrëdhëniet që i mbajmë me të gjitha vendet e Ballkanit janë në interes të të gjithë rajonit. Me këtë rast dua të theksoj se ne dëshirojmë që dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit të vazhdojë dhe të përfundojë me sukses.

"Kosova Sot": Ka pasur paralajmërime vite më parë për një bashkëpunim në fushën e arkivave, gjë që është e rëndësishme për të hedhur drítë nga e kaluara.

Kontribut serioz për Kosovën

"Kosova Sot": Si po ndihmohet diplomacia kosovare nga Ankaraja zyrtare?

Ambasadorja Ozan: Turqia jep kontribut serioz në përpjekjet e Kosovës që ta zërë vendin e saj në komunitetin ndërkombëtar dhe të njihet nga sa më shumë shtete të tjera. Lidhur me këtë çështje, ne jemi në kontakt aktiv me institucionet e Kosovës. Kryeministri ynë, në muajin shtator të vitit të kaluar, në fjalimin që e mbajti Nju-Jork, në Këshillin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, theksoi se njohja e shtetit të Kosovës është e pashmangshme, në mënyrë që në Ballkan të sigurohet paqja dhe stabiliteti. Ky fjalim i kryeministrit tonë shpreh në mënyrë të qartë qëndrimin tonë lidhur me këtë çështje. Ne besojmë se pavarësia, integriteti territorial dhe sovraniteti i Kosovës janë ndër çështjet thelbësore të stabilitetit dhe paqes në Ballkan.

përgjithshëm, një ekonomi që prodhon dhe integrohet në botën e zhvilluar, ka nevojë për investitorë të jashtëm. Unë i vëzhgoj me lëvdatë angazhimet, lehtësimet dhe stimulimet që Qeveria e Kosovës i ofron për investitorët e jashtëm. Siç e dini, viteve të fundit, përkundër krizave ekonomike globale, Turqia po e tregon një sukses mbresëlënës në zhvillimin e saj ekonomik. Turqia, së bashku me Kinën dhe Indinë, po e tregon trendin më të shpejtë të rritjes dhe zhvillimit dhe rrjedhimisht ka arritur të radhitet në vendin e 6-të të ekonomive më të zhvilluara në Evropë dhe në vendin e 16-të të vendeve më të zhvilluara në botë. Sektori i kontaktimit turk është duke realizuar investime miliardëshe në Afrikë, Azi, Ballkan, Kaukaz, Lindje të Mesme dhe në gjithë botën. Kjo vlen edhe për Kosovën, ku dihet se në Kosovë ka investime serioze turke. Këto investime janë realizuar në fusha të ndryshme, si infrastrukturë, shërbime bankare, sigurime, shëndetësi, arsim, ushqim dhe shumë e shumë fusha të tjera, e nuk kontribuojnë vetëm në rimëkëmbjen ekonomike të vendit, ato njëherësh punësojnë një numër të konsiderueshëm të qytetarëve të Kosovës. Pa dyshim, këto investime, e posaçërisht investimet që do ta rritin numrin e të punësuarve do të vazhdojnë edhe më tej, kur dihet se edhe marrëdhëniet tona tregtare janë në zhvillim të vazhdueshëm.

VAZHDON NË FAQE 8